



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT
(Përfundimtar)**

PËR

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË LIDHJE ME PROCESIN E
DEKLARIMIT TË STATUSIT TË PUNËSIMIT TË NËPUNËSVE CIVILË**

BASHKIA VORË

Tiranë, Janar 2016

RAPORT

Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve civilë të institucionit, Bashkia Vorë.

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështjete të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, (i ndryshuar) dhe në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes, miratuar me Vendimin nr.19, datë 11.03.2015, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes tematike në institucionin e Bashkisë Vorë, me Vendimin nr.120, datë 05.11.2015 *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Vorë”*.

Për shkak të riorganizimit administrativo-territorial, organet e qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve të vitit 2015, organizohen dhe funksionojnë bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuar në ligjin nr. 115/2014 *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*.

Në rastin konkret, shtrirja territoriale e Bashkisë së Vorës, si organ i qeverisjes vendore, përfshin edhe njësi vendore të organizuara më parë si njësi të pavarura të qeverisjes vendore, të tilla si, Komuna Bërxull dhe Komuna Prezë, të cilat, në bazë të ligjit nr. 30/2015 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar”*, janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, do të jenë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”*, Kreu III, *“Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve”*, pika 1, përcaktohet se, bashkia është trashëgimtari ligjor i njërive të qeverisjes vendore që janë shkrië në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njërive të qeverisjes vendore që janë shkrië. Më tej, në Kreun IV të këtij akti nënligjor, *“Transferimi i personelit”*, parashikohet se, marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njërive që janë shkrië dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj.

Në këto rrethana, kryerja e mbikëqyrjes në këtë institucion, me objekt plotësimin e kushteve ligjore të statusit të punësimit, të parashikuara në nenin 67 të ligjit 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, (i ndryshuar), si dhe në Vendimin nr.116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”*, është shtrirë edhe në njësitë administrative, pjesë përbërëse të strukturës së institucionit, Bashkia Vorë.

Sipas Programit të Mbikëqyrjes, nr. 770/1 prot., datë 05.11.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr.770/2 prot., datë 05.11.2015 “Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes”, grupi i punës u paraqit në institucion në datën 10.11.2015.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është tematik dhe përfshin verifikimin e procesit të deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve, të cilët, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes për Bashkinë Vorë duke përfshirë edhe Njësitë Administrative Bërxull dhe Prezë, të cilin ja ka dërguar për njohje, me shkresën nr.770/3 prot., datë 22.12.2015, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur observacionet. Pas kësaj, me shkresën nr.1567/1 prot., datë 07.01.2016, institucioni ka dërguar të nënshkruar projektraportin duke u shprehur dakort me konkluzionet që ka paraqitur grupi i kontrollit. Projektraporti është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Qëllimi i mbikëqyrjes

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

Objekti i mbikëqyrjes

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion.

- Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit Civil*”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit.
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune.
Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil.
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.
3. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (*njesisë përgjegjëse*), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar).

Metodologjia e mbikëqyrjes

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin në institucion të dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, si për institucionin Bashkia Vorë ashtu edhe për Njësitë Administrative, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht, u realizua një takim me Zv/Kryetarin e Bashkisë Vorë ***** , gjatë të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim. ***** , me detyrë Sekretare e Përgjithshme, u caktua si personi i kontaktit me grupin e punës.
- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës për Bashkinë Vorë, si dhe për Njësitë Administrative që janë pjesë përbërëse e saj.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe dosjet individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme që duhet të plotësojnë nëpunësit për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si niveli arsimor, përvoja në punë, etj.
- U administrua dokumentacioni i kërkuar, ku përfshihen listëprezencat e punonjësve për periudhën *shkurt 2014* dhe për periudhën *Tetor 2015* si dhe

evidenca e punonjësve, që njësitë administrative kanë dorëzuar pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Vorë.

- U verifikuan aktet e deklaramit të statusit të nëpunësit civil për të gjithë nëpunësit e bashkisë dhe të njërive administrative, të lëshuara nga njësia e personelit.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete (*Aneksi 1 dhe Aneksi 2*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti.

Përmbajtja e raportit:

I. Si është kuptuar ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), në lidhje me procesin e deklaramit të statusit të punësit.

a) Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes në Bashkinë Vorë.

Institucioni i Bashkisë është krijuar dhe funksionon mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*", (i ndryshuar), i cili e përcakton atë, si njësi të qeverisjes vendore, e si e tillë përfshihet në fushën e shërbimit civil.

Edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar), ky institucion përfshihet në fushën e veprimt të këtij ligji, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Menaxhimi i shërbimit civil në këtë institucion, është bërë mbi bazën e strukturave organizative të miratuara nga Këshilli Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*", (i ndryshuar), i cili, në nenin 32 gërma "ç", përcaktonte se, struktura dhe organika e administratës së bashkisë, miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Nga analiza e dokumentacionit që është vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar), (datë 26.02.2014), Bashkia Vorë, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 30, datë 24.12.2013 të Këshillit Bashkiak "*Mbi strukturën e Bashkisë Vorë për vitin 2014*". Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, institucioni i mbikëqyrur kishte gjithsej 65 pozicione pune, nga të cilat, 42 pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Kjo strukturë ka pësuar ndryshime dhe konkretisht, me Vendimin nr. 38, datë 24.12.2014 të Këshillit Bashkiak "*Mbi strukturën e Bashkisë Vorë për vitin 2015*", janë shtuar në strukturë gjithsej 10 pozicione pune, nga të cilat 8 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil, dhe në këtë mënyrë, numri i pozicioneve të punës gjithsej bëhet 75 pozicione, ndërkohë që 50 pozicione pune janë pjesë të shërbimit civil.

Më pas, për shkak të riorganizimit, bazuar në ligjin nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar”, pas miratimit të numrit të punonjësve nga Këshilli Bashkiak me Vendimin nr. 7, datë 05.08.2015, është miratuar struktura organizative e Bashkisë Vorë dhe e Njësive Administrative nga Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 6, datë 20.08.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë”.

Si konkluzion, vëmë në dukje se, në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin Bashkia Vorë, është kryer procesi i ristrukturimit, në përfundim të të cilit rezultojnë gjithsej **85** pozicione pune, nga të cilat, **57** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues është **1** pozicion pune, i cili i përket pozicionit “Sekretar i Përgjithshëm”, ose **2 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil;
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues është **1** pozicion pune, i cili i përket pozicionit “Drejtor Drejtorie”, ose **2 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **12** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori” ose **21 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil;
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **43** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Specialist/Inspektor” ose **75 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil.

Nga kontrolli i ushtruar, si dhe nga materialet që na janë vënë në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore, mënyra e plotësimit të pozicioneve që janë pjesë e shërbimit civil në momentin e realizimit të mbikëqyrjes dhe pjesa që zënë në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, paraqitet si më poshtë:

- 12 pozicione pune që zënë **21 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë të plotësuara nga nëpunës që janë rekrutuar si nëpunës civilë sipas procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Në këtë rast, momenti i fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i ka gjetur këto procedura rekrutimi të papërfunduara.
- 11 pozicione pune që zënë **19 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë të plotësuara nga nëpunës të emëruar me emërim të përkohshëm, të cilët data 26.02.2014, që është edhe momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin

civil”, (i ndryshuar), i ka gjetur këta punonjës, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Konstatohet se,

- në **10** raste, kohëzgjatja e periudhës së punësimit në të njëjtin vend pune, ka qenë më e madhe se 1 vit;
 - në **1** rast, kohëzgjatja e periudhës së punësimit në të njëjtin vend pune, ka qenë më e vogël se 1 vit.
- **8 pozicione pune** që zënë **14 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar nga nëpunës të emëruar me akte emërimi të përkohshme pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar).
 - **5 pozicione pune** që zënë **9 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar nga nëpunës civil, të cilët janë transferuar si rezultat i ristrukturimit.
 - **21 pozicione pune** që zënë **37 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë vende të lira (**17 pozicione pune të lira i përkasin pozicionit “Specialist” dhe 4 pozicione të lira i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori”**).
- b) Plotësimi i kushteve ligjore për të përfituar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që institucioni i mbikëqyrur është pjesë e shërbimit civil, atëherë deklarimi si nëpunës civilë ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar), neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;
- pika 4, “Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;

- *pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.*

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave ”Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 ”Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), Kreu II ”Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, pika 1, është përcaktuar se: ”Nëpunës civilë”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil” dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 ”Statusi i nëpunësit civil”.

Dispozitat e sipërpërmendura, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarinin e statusit të punësimit, pas verifikimit të procedurës së punësimit për gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarinin e statusit të punësimit, grupi i mbikëqyrjes, verifikoi dhe analizoi të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën e institucionit, e cila ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit; listëprezencën dhe listëpagesën e muajit shkurt 2014; dokumentacionin e plotë që vërteton procedurën e marrjes në punë, përfshirë aktin e emërimit apo kontratën e punësimit; librezën e punës, si dokument që vërteton hyrjen në punë dhe kohëzgjatjen e punësimit, si dhe të dhënat profesionale dhe çdo të dhënë tjetër lidhur me marrëdhëniet e punës në shërbimin civil.

Nga përpunimi dhe analiza e këtij dokumentacioni konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), ashtu si e kemi deklaruar edhe me sipër, institucioni i mbikëqyrur ka pasur **42** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, nga të cilat **20** pozicione pune të zëna dhe **22** pozicione pune të lira.

Për të gjitha rastet e klasifikuara si nëpunës, të cilët në datën 26.02.2014, kanë qenë të punësuar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil, u verifikua dokumentacioni që vërteton procedurën e marrjes në punë dhe rezulton situata si më poshtë:

b.1) Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në ligjin nr. 8549/1999 ”Statusi i nëpunësit civil”.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, konstatohen në **3** raste, punonjës ekzistues, që janë punësuar fillimisht nëpërmjet emërimit të përkohshëm dhe më pas kanë konkurruar për pranimin në shërbimin civil, sipas ligjit nr. 8549/1999 ”Statusi i nëpunësit

civil". Fillimi i efekteve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), i ka gjetur në proces rekrutimi.

Në këtë rast, bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

*****, punësuar me emërim të përkohshëm, me aktin nr.17, datë 03.01.2012, në pozicionin "Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Kontrollit". Me aktin nr.86/2, datë 10.04.2014, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin e mësipërm dhe pas përfundimit të periudhës së provës, me aktin nr.134/5, datë 15.04.2015, është konfirmuar si nëpunës civil.

*****, punësuar me emërim të përkohshëm, me aktin nr.216, datë 01.11.2013, në pozicionin "Specialiste në Sektorin e Burimeve Njerëzore". Me aktin nr.78/2, datë 10.04.2014, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin e mësipërm dhe pas përfundimit të periudhës së provës, me aktin nr.134/2, datë 15.04.2015, është konfirmuar si nëpunës civil.

*****, punësuar me emërim të përkohshëm, me aktin nr.6, datë 03.01.2012, në pozicionin "Specialiste në Sektorin e Ujësjetësimit". Me aktin nr.92/2, datë 10.04.2014, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin e mësipërm, por më pas, me aktin nr.16/5, datë 01.09.2015, ajo është larguar nga kjo detyrë për shkak të mosparaqitjes në punë. Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, pozicioni i punës "Specialist në Sektorin e Ujësjetësimit", rezulton vend i lirë.

Në datën e fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, procedurat e konkurrimit për këta punonjës, kanë qenë në proces (faza e tretë, që është faza e vlerësimit përfundimtar të kandidatëve nga eprori direkt dhe përzgjedhja e fituesit, ka përfunduar në datën 24.02.2014).

Kjo procedurë ka përfunduar sipas dispozitave të ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil", ashtu si përcaktohet në nenin 68, pika 2 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar).

Konfirmimi i tyre si nëpunës civilë, pas përfundimit të periudhës së provës, është bërë sipas afateve dhe procedurës mbështetur në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), pasi, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014), në Kreun IV "Dispozita transitorë", pika 4 dhe 5, përcaktohet se, nëpunësit civilë, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, parashikuar nga ligji nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil", dhe që janë në periudhë prove, vazhdojnë periudhën e provës sipas afateve dhe procedurës së vlerësimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar).

Grupi i punës verifikoi përmbushjen e kërkesave ligjore gjatë periudhës së provës, të përcaktuara nga neni 24 i ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar) dhe Kreu V, i Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese".

Rezultoni se, ky akt nënligjor është shfuqizuar pas daljes së Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", ndërkohë që në këtë vendim, pika 1, Kreu IX "Dispozita tranzitore", parashikohet se, procedurat e pranimit, lëvizjes paralele dhe periudhës së provës, që kanë filluar sipas parashikimeve të vendimit të shfuqizuar, do të përfundojnë sipas të njëjtit akt.

Mbështetur në këto dispozita ligjore, gjatë periudhës së provës, nëpunësi civil, është i detyruar që të kryejë ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), ndërsa institucioni, ka detyrimin, që të përzgjedhë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove dhe të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore.

Vendimi i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil në përfundim të periudhës së provës merret bazuar në:

- Rezultatit e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA);
- Vlerësimit të rezultateve individuale në punë, i cili bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor që rregullon institutin e vlerësimit të arritjeve vjetore.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se, procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës, është kryer mbi bazën e rezultateve të testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), si dhe mbi bazën e vlerësimit të rezultateve individuale në punë.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, në kuptim të nenit 67 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), si dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014), njësia përgjegjëse, ka vepruar drejt duke i konsideruar nëpunësit e cituar më sipër si nëpunës civilë në periudhë prove dhe më pas, duke i konfirmuar nëpunës civilë.

b.2) Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar).

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezultoni se në 17 raste, pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme dhe me kontratë pune, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit, sikurse përcaktohej në nenin 13 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Megjithëse kjo dispozitë ligjore përcaktonte konkurrimin, si të vetmen mënyrë të rekrutimit në shërbimin civil, marrëdhëniet e punës për këta punonjës, kanë vazhduar të rregullohen sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit për këtë kategori punonjësish, mbështetur në përmbajtjen e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), si dhe nisur nga momenti i emërimit, që del nga procesi i këqyrjes së akteve të emërimit, konstatohet se:

- në **14** raste, punonjësit ekzistues që janë të punësuar në të njëjtin vend pune, kanë një periudhë më tepër se 1 vit në atë pozicion.

Duke u nisur nga analiza që i është bërë akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton i vërtetë fakti se këta punonjës, kanë më shumë se një vit, nga momenti që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në ato pozicione pune.

Për këtë kategori nëpunësish, konstatohet se, njësia përgjegjëse, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si nëpunës civilë, me vendimet respektive datë 01.05.2014.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore, ka vepruar drejt në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civilë për këtë kategori punonjësish.

Aktet që dokumentojnë këtë proces, janë të evidentuara në tabelën **Aneks 1** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar)”, Bashkia Vorë.

- në **2** raste, punonjësit ekzistues që janë të punësuar në të njëjtin vend pune, kanë një periudhë më pak se 1 vit në atë pozicion.

Nga këqyrja e dokumentacionit të dosjeve personale rezulton se, momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, i ka gjetur këta punonjës në një pozicion pune, ku periudha e punësimit ka qenë më e vogël se një vit.

Bëhet fjalë për punonjësit *****; *Specialiste në Sektorin e Financës*, dhe *****; *Përgjegjës i Sektorit të Ujësjetës*, për të cilët, në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, njësia përgjegjëse, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë në periudhë prove.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, për të dy këta nëpunës, procedura e vendimmarrjes në përfundim të periudhës së provës, nuk ka përfunduar, për shkak se, në rastin e punonjës ***** rezulton se ka qenë me Raport Mjekësor për leje lindje, (Shtator 2014-Prill 2015), ndërsa, në rastin e punonjës ***** konstatohet se, me aktin nr. 7/2, datë 02.09.2014, ai është liruar nga kjo detyrë për arsye të kërkesës së tij për dorëheqje.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, në kuptim të nenit 67 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), si dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014), njësia përgjegjëse, ka vepruar drejt duke i konsideruar nëpunësit e cituar më sipër si nëpunës civilë në periudhë prove.

Në rastin e punonjësit ***** , vlerësohet se, nga njësia përgjegjëse, është vepruar në mbështetje të kërkesave të nenit 64 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), ku parashikohet dorëheqja si institut i ligjit, e cila i prodhon pasojat duke respektuar procedurat ligjore për miratimin e saj.

- në 1 rast nuk është nxjerrë akti i deklarimit të statusit të punësimit, me pretendimin se pozicioni i punës “*Specialist Arkive*”, nuk konsiderohet si pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në këtë rast, bëhet fjalë për punonjësen ***** , e emëruar në pozicionin “*Specialiste Arkive*”, me aktin nr. 1, datë 11.01.2006.

Ndërkohë, në analizë të rregullimeve ligjore në lidhje me këtë aspekt, rezulton se veprimi i njësisë përgjegjëse në këtë rast, nuk është bërë në përputhje me kërkesat specifike që rregullojnë marrëdhëniet e punësimit në lidhje me këtë pozicion pune.

Në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), ky pozicion pune ka qenë dhe vijon të mbesë pjesë e shërbimit civil, në kushtet kur realizon një funksion publik. Për më tepër, përfshirja e këtij pozicioni në shërbimin civil është e përcaktuar edhe në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

Konkretisht, në pikën 9 të këtij akti nënligjor, klasifikohen pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive, sipas natyrës së pozicionit në **a) grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm;** dhe **b) grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.**

Ndërkohë, sipas pikës 12 të këtij akti nënligjor, grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm përcaktohen në Lidhjen nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e tij. Më tej, Lidhja nr. 3 “Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës”, në kolonën e parë, ka renditur grupin e specialistëve të institucioneve të administratës publike, që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, bazuar mbi profesionet përkatëse. Në këtë renditje, rezulton se në grupin që i përket ndarjes me numër rendor 26, përcaktohet në mënyrë të shprehur emërtesa e pozicionit të punës “specialistë të arkivave”, si pozicione që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil.

Konkluzion: Nga sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pozicioni i punës “*Specialist Arkive*”, duhet të konsiderohet si pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Për këtë arsye, rekomandohet njësia përgjegjëse, që të nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për punonjësen *****, në kategorinë ”nëpunëse civile” në pozicionin “Specialiste Arkive”.

b.3) Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të paplotësuara (vakant)

Gjatë verifikimit u konstatua se, në Bashkinë Vorë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 ”Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), janë **22 pozicione pune të paplotësuara**, nga të cilat:

- **10 pozicione pune**, janë plotësuar me procedurat e konkurrencës sipas ligjit nr. 8549 /1999 ”Statusi i nëpunësit civil” (i shfuqizuar), të cilat, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), ishin në proces dhe për këtë arsye, kanë përfunduar sipas dispozitave të ligjit nr. 8549/1999.

Këto raste po i rendisim më poshtë:

1. *Përgjegjës në Sektorin e Auditit të Brendshëm*, me aktin nr. 81/2, datë 10.04.2014 është emëruar nëpunës civil në periudhë prove *****. Akti i konfirmimit nr.134/13, datë 15.04.2015. Konstatohet se, me aktin nr.26/3, datë 01.09.2015, është emëruar në pozicionin *Specialiste në Sektorin e Financës* me dëshirën e saj (*kërkesë, protokolluar me nr.3, datë 01.09.2015*).
2. *Inspektor në Sektorin e Bujqësisë dhe Veterinerisë*, me aktin nr. 94/1, datë 10.04.2014 është emëruar nëpunës civil në periudhë prove *****. Akti i konfirmimit nr.134/1, datë 15.04.2015.
3. *Specialist në Sektorin e Pronave Publike dhe Pyjeve*, me aktin nr. 90/1, datë 10.04.2014 është emëruar nëpunës civil në periudhë prove *****. Akti i konfirmimit nr.134/6, datë 10.04.2015.
4. *Specialist në Sektorin e Pronave Publike dhe Pyjeve*, me aktin nr. 79/1, datë 10.04.2014 është emëruar nëpunës civil në periudhë prove *****. Akti i konfirmimit nr.134/7, datë 15.04.2015.
5. *Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave*, me aktin nr. 80/1, datë 10.04.2014 është emëruar nëpunës civil në periudhë prove *****.
6. *Specialist në Sektorin e Shërbimeve Sociale*, me aktin nr. 84/2, datë 10.04.2014 është emëruar nëpunës civil në periudhë prove *****. Akti i konfirmimit nr.134/8, datë 15.04.2015.
7. *Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun*, me aktin nr. 85/2, datë 10.04.2014 është emëruar nëpunës civil në periudhë prove *****. Akti i konfirmimit nr.134/11, datë 15.04.2015.
8. *Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun*, me aktin nr. 83/1, datë 10.04.2014 është emëruar nëpunës civil në periudhë prove *****. Akti i konfirmimit nr.134/10, datë 15.04.2015.
9. *Përgjegjës në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*, me aktin nr. 88/2, datë 10.04.2014 është emëruar nëpunës civil në periudhë prove *****. Akti i konfirmimit nr.134/4, datë 15.04.2015. Konstatohet se,

me aktin nr.65/3, datë 01.10.2015 ka kaluar në pozicionin *Specialist* me dëshirën e tij.

10. *Specialist në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*, me aktin nr. 91/1, datë 08.04.2014 është emëruar nëpunës civil në periudhë prove *****. Akti i konfirmimit nr.134/3, datë 15.04.2015.

Për të gjithë nëpunësit e emëruar në këto pozicione, rezulton se, pas përmbushjes së periudhës së provës, kanë dalë aktet e konfirmimit si nëpunës civilë (*përveç rastit të nëpunëses ******, e cila rezulton me Raport Mjekësor për leje lindje). Edhe në këto raste, procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës, është kryer mbi bazën e rezultateve të testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), si dhe vlerësimit të rezultateve individuale në punë.

Konkluzion: Nga sa analizuar më sipër, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, ka vepruar drejt duke i konsideruar nëpunësit e cituar më sipër si nëpunës civilë në periudhë prove dhe duke i konfirmuar ata si nëpunës civilë sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

- 4 pozicione pune janë të zëna me emërimet të përkohshme pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013 ”Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), (*më hollësisht këto raste trajtohen në një pikë të veçantë të projektraportit*).
- 8 pozicione pune vijojnë të jenë vende të lira.

- c) Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), konstatohet se, në këtë institucion, në **8** raste, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme.

Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

*****, me aktin nr.59, datë 15.01.2015, është emëruar në pozicionin *Sekretar i Përgjithshëm*. Konstatohet se, me aktin nr.102/1, datë 01.05.2014, kjo nëpunëse, është deklaruar nëpunëse civile në pozicionin ”Përgjegjës në Sektorin e Burimeve Njerëzore”. Emërimi në pozicionin *Sekretar i Përgjithshëm*, është konsideruar si *transferim për interesa të institucionit* (ky pozicion është parashikuar në strukturën e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.38, datë 24.12.2014).

*****, me aktin nr.26/2, datë 16.09.2015, është emëruar në pozicionin *Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm Financiar*.

*****, me aktin nr.13/19, datë 01.09.2015, është emëruar në pozicionin *Specialiste në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*.

*****, me aktin nr.13/20, datë 01.09.2015, është emëruar në pozicionin *Përgjegjës në Sektorin e Bujqësisë dhe Veterinerisë*.

*****, me aktin nr.13/26, datë 01.09.2015, është emëruar në pozicionin *Specialiste në Sektorin e Shërbimeve Sociale*.

*****, me aktin nr.13/21, datë 01.09.2015, është emëruar në pozicionin *Përgjegjëse në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun*.

*****, me aktin nr.65/4, datë 01.10.2015, është emëruar në pozicionin *Përgjegjës në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*.

*****, me aktin nr.60, datë 15.01.2015, është emëruar në pozicionin *Përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore*.

Konkluzion: Komisioneri konstaton se, këto akte, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Në këtë rast, rekomandohet njësia përgjegjëse, që, për rregullimin e situatës, duhet të revokojë aktet e emërimit për punonjësit e cituar më sipër.

Pozicionet e punës, *Sekretar i Përgjithshëm, Përgjegjës në Sektorin e Bujqësisë dhe Veterinerisë, Përgjegjës në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, Përgjegjës në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Përgjegjës në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm Financiar, Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Specialist në Sektorin e Shërbimeve Sociale*, duhet të shpallen vende të lira për t'u plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

d) *Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara nga nëpunës të transferuar për shkak ristrukturimi të institucionit.*

Gjatë procesit të verifikimit në Bashkinë Vorë, u konstatua se në 5 raste, janë emëruar punonjës me anë të transferimit nga Njësitë Administrative Bërxull, Prezë dhe Kashar, për shkak të ristrukturimit të tyre.

Siç e kemi thënë edhe në fillim të materialit, si pasojë e reformës territoriale, njësitë e qeverisjes vendore Komuna Bërxull dhe Komuna Prezë, tashmë funksionojnë si Njësi Administrative të Bashkisë Vorë dhe për pasojë, burimet njerëzore të tyre administrohen nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Vorë.

Për rrjedhojë, mbështetur në ligjin nr. 30/2015 "Për disa dhe ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Vorë, me Vendimin nr.7, datë 05.08.2015 "Mbi miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative", ka miratuar në total numrin e punonjësve të Bashkisë Vorë, duke përcaktuar se Njësia Administrative Bërxull do të funksionojë me 26 punonjës gjithsej, ndërsa Njësia

Administrative Prezë, do të funksionojë me 16 punonjës gjithsej, dhe më pas, është miratuar struktura nga Kryetari i Bashkisë Vorë me Urdhrin nr.6, datë 20.08.2015.

Në vijim të këtij procesi, njësia përgjegjëse e Bashkisë Vorë, ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit, me Urdhrin nr.8, datë 20.08.2015, e parashikuar në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), si dhe në pikën 17 të Kreut III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”.

Në përfundim, bazuar në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Vorë, ka vendosur si më poshtë:

1. ***** , me aktin nr.13/55, datë 01.09.2015, “Transferim për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, është emëruar në pozicionin *Përgjegjëse në Sektorin e Auditimit të Brendshëm Financiar*.

Konstatohet se, kjo punonjëse, ka punuar në pozicionin *Përgjegjëse e Zyrës së Financës* në Komunën Bërxull, aktualisht Njësia Administrative Bërxull, e emëruar në këtë pozicion me aktin nr.36, datë 17.11.2011 dhe e deklaruar nëpunëse civile me aktin nr.579, datë 29.09.2014.

Sipas strukturës së miratuar, rezulton se, pozicioni i punës *Përgjegjës Zyre Finance, në Njësine Administrative Bërxull, është shkurtuar*. Ndërkohë, pozicioni i punës *Përgjegjës në Sektorin e Auditimit të Brendshëm Financiar* pranë Bashkisë Vorë, ka rezultuar i lirë për shkak të dorëheqjes nga kjo detyrë të punonjësës ***** (e cila ka kaluar *Specialiste në Sektorin e Financës*).

2. ***** , me aktin nr.14/5, datë 01.09.2015, “Transferim për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, është emëruar në pozicionin *Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*.

Nga verifikimi rezulton se, ky punonjës, ka punuar pranë Komunës Bërxull, aktualisht Njësia Administrative Bërxull, në pozicionin *Përgjegjës i Zyrës së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*, i emëruar me aktin nr.8, datë 07.02.2014.

Njësia e burimeve njerëzore të Komunës Bërxull, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për tu shprehur në lidhje me Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit, e ka deklaruar *nëpunës civil* në pozicionin e mësipërm, me aktin nr.579/4, datë 29.09.2014.

Por, nga sa më sipër, momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, e ka gjetur këtë punonjës në një pozicion pune, *ku periudha e punësimit ka qenë më e vogël se një vit*.

Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 67 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), si dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014), ky punonjës, duhet të konsiderohej *nëpunës civil në periudhë prove*.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse, që, në zbatim të nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative "Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative", të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësni ******, duke i shtuar faktin që ai duhet të konsiderohet në periudhë prove.

Në këtë rast, pas përfundimit të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA) dhe pas vlerësimit të punës nga eprori, njësia përgjegjëse duhet të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.

Vëmë në dukje se, sipas strukturës së miratuar për Njësinë Administrative Bërxull, pozicioni i punës *Përgjegjës i Zyrës së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*, është shkurtuar, ndërkohë që rezultojnë tre pozicione pune të lira në kategorinë "Specialist" në *Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit* pranë Bashkisë Vorë, një nga të cilat është plotësuar nëpërmjet transferimit për shkak ristrukturimi nga punonjësi ******, ndërsa dy pozicione pune vijojnë të jenë të lira.

3. ******, me aktin nr.14/4, datë 01.09.2015, "Transferim për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit", është emëruar në pozicionin *Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave*.

Konstatohet se, ky punonjës ka punuar pranë Komunës Bërxull, aktualisht Njësia Administrative Bërxull, i emëruar me aktin nr.28, datë 02.11.2012 në pozicionin Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave dhe më pas, me aktin nr.20, datë 01.07.2013 ka kaluar në pozicionin Specialist arkive, i deklaruar nëpunës civil me aktin nr.579/6, datë 29.09.2014.

Sipas strukturës së miratuar, rezultojnë tre pozicione pune të lira *Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave*, pranë Bashkisë Vorë, një nga të cilat është plotësuar nëpërmjet transferimit për shkak ristrukturimi nga punonjësi ******, ndërsa dy pozicione vijojnë të jenë të lira.

4. ******, me aktin nr.14/6, datë 01.09.2015, "Transferim për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit", është emëruar në pozicionin *Specialist në Sektorin e Financës*.

Nga verifikimi rezulton se, kjo punonjëse, ka punuar pranë Komunës Prezë, aktualisht Njësia Administrative Prezë, në pozicionin *Specialiste në Zyrën e Tatim Taksave*, e emëruar me kontratë pune nr.69/1 prot., datë 15.01.2014.

Njësia e burimeve njerëzore të Komunës Prezë, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për tu shprehur në lidhje me Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit, e ka deklaruar nëpunës civil në pozicionin *Specialiste në Zyrën e Tatim Taksave*, me aktin nr.229, datë 08.06.2015.

Por, nga sa rezulton më sipër, momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, e ka gjetur këtë punonjëse në një pozicion pune, ku periudha e punësimit ka qenë më e vogël se një vit.

Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 67 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), si dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014), kjo punonjëse, duhet të konsiderohej nëpunës civil në periudhë prove.

Konkluzion: Në këto kushte, Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse të Bashkisë Vorë, që në zbatim të nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative ”Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative”, të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësit për punonjësën *****, duke i shtuar faktin që ajo duhet të konsiderohet në periudhë prove.

Në këtë rast, pas përfundimit të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA) dhe pas vlerësimit të punës nga eprori, njësia përgjegjëse duhet të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.

Vëmë në dukje se, sipas strukturës së miratuar për Njësinë Administrative Prezë, janë shkurtuar dy pozicione në Sektorin e Tatim Taksave, ndërkohë që rezultojnë dy pozicione pune të lira në kategorinë “Specialist” në Sektorin e Financës, pranë Bashkisë Vorë, një nga të cilat është plotësuar nëpërmjet transferimit për shkak ristrukturimi nga punonjësja ***** , ndërsa një pozicion pune vijon të jetë i lirë.

5. ***** , me aktin nr.23/4, datë 23.09.2015, “Transferim për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, është emëruar në pozicionin *Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm Financiar*.

Nga këqyrja e akteve, konstatohet se, punonjësja ***** , ka punuar pranë Komunitetit Kashar, aktualisht njësi administrative e Bashkisë Tiranë, në pozicionin *Specialiste e Prokurimeve Publike* pranë *Zyrës Juridike*, e emëruar me aktin nr.2905, datë 09.11.2008 dhe e deklaruar nëpunës civil me aktin nr.2092, datë 25.09.2014.

Për emërimin në pozicionin *Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm Financiar* pranë Bashkisë Vorë, njësia përgjegjëse, ka ndjekur procedurën e transferimit të përkohshëm, të përcaktuar në nenin 48 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), si dhe në Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, Kreu I “Transferimi i përkohshëm”.

Në rastin konkret, titullari i Bashkisë Vorë, me shkresën nr.247 prot., datë 02.09.2015, ”Kërkesë për transferim të përkohshëm”, i është drejtuar Bashkisë Tiranë, si njësia përgjegjëse për Njësinë Administrative Kashar, që për nevoja të institucionit, të transferojë pranë Sektorit të Auditimit të Bashkisë Vorë, në të njëjtën kategori ”Specialist”, ***** , kërkesë, e cila është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë me shkresën nr.12139/1, datë 22.09.2015.

Pas miratimit, ka dalë akti nr.23/4, datë 23.09.2015 për emërimin në pozicionin *Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm Financiar*, pranë Bashkisë Vorë, i cili rezulton të ketë qenë vend i lirë.

II. Pasqyrimi i procesit të deklarimit të statusit të punësimit në dosjen e personelit

a. Dosja e Personelit

Në zbatim të programit, grupi i punës verifikoi dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Konstatohet se, të gjitha dosjet e nëpunësve janë të plotësuara me fletëinventarin dhe fletën prezantuese sipas Lidhjes 1 dhe 2 bashkëlidhur Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*” dhe janë të plotësuara me të gjitha të dhënat e kërkuara.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se janë të përfshira dokumenta me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se, në dosjet personale të nëpunësve, administrohet dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnjoftimit*); dokumenti mbi gjendjen civile (*çertifikata e gjendjes familjare*); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*), dokumentet që vërtetojnë fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*); dokumenti i vërtetimit të gjendjes gjyqësore, apo çertifikata e kontrollit shëndetësor (*Raporti Mjekësor*), si dhe aktet që provojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit.

Konkluzion: Në këto rrethana, Komisioneri çmon se, dosjet e personelit, janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore.

b. Rregjistri i personelit

Rregjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Në kushtet kur, ende nuk është bërë funksional Rregjistri Qendror i Personelit, që sipas ligjit administrohet nga Departamenti i Administratës Publike, në një mënyrë specifike, sipas përcaktimeve të bëra në një akt nënligjor të veçantë, rezulton se të dhënat që përmban regjistri i personelit në institucion, pasqyrojnë gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

III. Situata e shërbimit civil, në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat aktualisht janë pjesë e Bashkisë Vorë, për shkak të reformës territoriale, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”(i ndryshuar).

➤ **Komuna Bërxull, aktualisht Njësia Administrative Bërxull**

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), përfshin në fushën e veprimit të tij edhe komunat, si njësi të pavarura të qeverisjes vendore, e përcaktuar kjo në nenin 2 të këtij ligji si dhe në pikën 2 të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit të ri për nëpunësin civil, Komuna Bërxull, aktualisht Njësia Administrative Bërxull, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 01.02.2013 të Këshillit të Komunës “Për miratimin e strukturës së administratës dhe numrit të punonjësve të Komunës Bërxull”, ndryshuar me Vendimin nr.10, datë 08.03.2013 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Komunës nr.2, datë 01.02.2013”.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo njësi kishte gjithsej **57** pozicione pune, nga të cilat, **16** pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.

Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, në këtë njësi administrative, është bërë në këtë mënyrë :

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **7** pozicione pune ose **44%** e pozicioneve të shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Zyre/Administrator”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **9** pozicione pune ose **56%** e pozicioneve të shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Specialist”.

Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në dosjet individuale të punonjësve, rezulton se, njësia përgjegjëse, e komunës, është shprehur në lidhje me Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit për këta punonjës.

Nisur nga analiza që i është bërë akteve të emërimit, mbështetur në listëpagesën e muajit shkurt 2014, mbi bazën e strukturës së miratuar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, si dhe, nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, kanë qenë të zëna si më poshtë:

- në **8** raste, punonjësit ekzistues që janë të punësuar në të njëjtin vend pune, kanë një periudhë më tepër se 1 vit në atë pozicion, nga momenti që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

Për këtë kategori punonjësish, njësia përgjegjëse, **në 7 raste**, me të drejtë, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë, me aktet respektive të datës 29.09.2014.

Në **1 rast**, njësia përgjegjëse, pasi ka bërë verifikimin e plotësimit të kriterëve për të qenë nëpunës civil, në Akt Verifikimin datë 25.09.2014 për punonjësin *****, është shprehur, për mospërfitimin e statusit për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor, në rastin konkret arsimit i lartë.

Konstatohet se, në momentin e mbikëqyrjes, si rezultat i ristrukturimit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Vorë, për këtë punonjës, ka nxjerrë aktin e përfundimit të marrëdhënies së punësimit nr. 16/17, datë 01.09.2015.

Konkluzion: Nga sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, ka vepruar drejt në lidhje me deklarin e statusit të punësimit për këtë kategori punonjësish.

Aktet që dokumentojnë këtë proces, janë të evidentuara në tabelën **Aneks 1** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar)”, Njësia Administrative Bërxull.

- në **3** raste, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në të njëjtin vend pune, kanë një periudhë më pak se 1 vit në atë pozicion, nga momenti që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

Në këto raste, njësia përgjegjëse, është shprehur si më poshtë:

*****, me aktin nr.8, datë 07.02.2014 është emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Zyrën e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, dhe me aktin nr. 579/4, datë 29.09.2014, është deklaruar nëpunës civil.

Në momentin e mbikëqyrjes, konstatohet se, ky punonjës, me vendimin nr.14/5, datë 01.09.2015 të njesisë përgjegjëse, është emëruar *Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*, pranë Bashkisë Vorë.

Grupi i punës konstaton se, në këtë rast, nuk është vepruar drejt nga njësia përgjegjëse e komunës, pasi, ky punonjës, nuk plotëson kushtet për t'u deklaruar nëpunës civil. Momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, e ka gjetur atë pa plotësuar ende periudhën prej një viti në këtë pozicion dhe për rrjedhojë, deklarimi i statusit të punësimit duhet të ishte bërë nëpunës civil në periudhë prove.

Ky konstatim është vënë në dukje edhe më lart në material, në pjesën ku flitet për situatën e administrimit të burimeve njerëzore në institucionin Bashkia Vorë, në paragrafin "d" të raportit "Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara nga nëpunës të transferuar për shkak ristrukturimi të institucionit", pika 2, ku bëhet fjalë në lidhje me emërimin e ***** në pozicionin Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, pranë Bashkisë Vorë, duke i lënë detyra njësisë përgjegjëse në lidhje me rregullimin e situatës në këtë rast.

***** me aktin nr.20, datë 01.07.2013, është emëruar "Përgjegjës në Zyrën e Tatim Taksave", dhe, me aktin e verifikimit datë 25.09.2014, njësia përgjegjëse është shprehur për mospërfitimin e statusit pasi diploma nuk përputhet me vendin e punës.

Në momentin e mbikëqyrjes, konstatohet se, ky punonjës, me vendimin nr.16/6, datë 01.09.2015 të njësisë përgjegjëse Bashkia Vorë, është liruar nga detyra për mosplotësimin e kriterëve dhe shkurtim të vendit të punës.

***** me aktin nr.20/1, datë 01.07.2013 është emëruar në pozicionin "Specialist në Zyrën e Tatim Taksave", dhe, me aktin nr. 579/4, datë 29.09.2014, është deklaruar nëpunës civil.

Edhe në këtë rast, ky punonjës duhet të konsiderohej nëpunës civil në periudhë prove, pasi momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, e ka gjetur atë pa plotësuar ende periudhën prej një viti në këtë pozicion.

Nga këqyrja e akteve konstatohet se, pas ristrukturimit, me aktin nr.13/25, datë 01.09.2015, ky punonjës është emëruar përsëri në pozicionin Inspektor i tatim taksave në Njësinë Administrative Bërxull.

Konkluzion: Në lidhje me këtë rast, Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse të Bashkisë Vorë, që, në zbatim të nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative "Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative", të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin ***** , duke i shtuar faktin që ai duhet të konsiderohet në periudhë prove.

Ndërkohë, njësia përgjegjëse, duhet të kujdeset për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), përcaktimin e një punonjësi më të vjetër për t'u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.

- në 5 raste, pozicionet e punës kanë rezultuar të lira.

Konstatohet se, tre pozicione pune si, Specialist në Zyrën e PKZHT, Specialist Veteriner dhe Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të ri, kanë qenë vende të lira.

Pozicionet e punës *Përgjegjës i Zyrës së MMT dhe Administrator i Ndihmës Ekonomike*, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të ri, kanë qenë të zëna nga punonjës, të cilët më pas janë larguar dhe për ta, grupi i punës, nuk mundi të siguronte asnjë të dhënë, pasi nuk kishte dosje individuale të dorëzuara nga Njësia Administrative Bërxull pranë Bashkisë Vorë.

Aktualisht, këto pozicione, me miratimin e strukturës pas ristrukturimit për Njësinë Administrative Bërxull, janë shkurtuar.

Të gjitha aktet që dokumentojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit në Njësinë Administrative Bërxull, janë të evidentuara në tabelat:

Aneks 1 “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar)”;

Aneks 2 “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”.

➤ **Komuna Prezë, aktualisht Njësia Administrative Prezë**

Komuna Prezë, që aktualisht është Njësia Administrative Prezë, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), ka qenë e organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 33, datë 27.11.2013 të Këshillit të Komunës “Për miratimin e pagës dhe strukturës organike të Komunës Prezë”.

Kjo strukturë ka ndryshuar për vitin 2015, kur është miratuar struktura organike me Vendimin nr.2, datë 23.01.2015 të Këshillit të Komunës, ndryshim i cili konsiston në shtimin e një pozicioni pune në kategorinë “*Specialist*”.

Megjithatë, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të ri (data 26.02.2014), rezulton se, kjo njësi ka pasur gjithsej **54** pozicione pune, nga të cilat, **20** pozicione pune konsiderohen si pjesë e shërbimit civil.

Konstatohet se, të gjitha pozicionet e shërbimit civil janë përfshirë në kategorinë ekzekutive, të cilat i përkasin pozicionit “*Përgjegjës Zyre*” (**9** pozicione pune) dhe “*Specialist*” (**11** pozicione pune).

Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në dosjet individuale të punonjësve, rezulton se, njësi përgjegjëse, e komunës, është shprehur në lidhje me Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit për këta punonjës.

Nisur nga analiza që i është bërë akteve të emërimit, mbështetur në listëpagesën e muajit shkurt 2014, mbi bazën e strukturës së miratuar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, si

dhe, nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, kanë qenë të zëna si më poshtë:

- në **10** raste, punonjësit ekzistues që janë të punësuar në të njëjtin vend pune, kanë një periudhë më tepër se 1 vit në atë pozicion, nga momenti që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

Për këtë kategori punonjësish, njësia përgjegjëse, me të drejtë ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civilë, me aktet respektive të datës 08.06.2015.

Aktet që dokumentojnë këtë proces, janë të evidentuara në tabelën **Aneks 1** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”, Njësia Administrative Prezë.

- në **3** raste, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në të njëjtin vend pune, kanë një periudhë më pak se 1 vit në atë pozicion, nga momenti që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

Në këto raste, njësia përgjegjëse, është shprehur si më poshtë:

*****, me aktin nr.8, datë 27.01.2014 është emëruar në pozicionin ”Specialist në Zyrën e Planifikimit të Territorit”, dhe, me aktin nr. 217, datë 08.06.2015, është deklaruar nëpunës civil.

Pas ristrukturimit, me aktin nr.22/3, datë 13.09.2015, është liruar nga detyra për shkak të shkurtimit të vendit të punës.

*****, me aktin nr.19, datë 15.04.2013 është emëruar në pozicionin ”Përgjegjës i Zyrës Juridike”, dhe, me aktin nr. 219, datë 08.06.2015, është deklaruar nëpunës civil.

Pas ristrukturimit, me aktin nr.23, datë 13.09.2015, është liruar nga detyra për shkak të shkurtimit të vendit të punës.

*****, me aktin nr.69/1, datë 15.01.2014 është emëruar në pozicionin ”Specialiste në Zyrën e Tatim Taksave”, dhe, me aktin nr. 229, datë 08.06.2015, është deklaruar nëpunës civil.

Pas ristrukturimit, me aktin nr.14/6, datë 01.09.2015, është emëruar *Specialiste në Sektorin e Financës* pranë Bashkisë Vorë.

Konkluzion: Komisioneri konstaton se, në të tre rastet, nuk është vepruar drejt nga njësia përgjegjëse e komunës, kur i ka deklaruar nëpunës civilë këta punonjës. Momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, i ka gjetur ata pa plotësuar ende periudhën prej një viti në këtë pozicion, prandaj, ata duhet të deklarohen nëpunës civilë në periudhë prove.

Por, nga ana tjetër, rezulton se, në rastin e punonjësve ***** dhe ***** , ata kanë shkëputur marrëdhënien e punësimit, pasi, njësia përgjegjëse e Bashkisë Vorë, në

përfundim të procesit të ristrukturimit, bazuar edhe në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit, ka vendosur lirim të tyre nga detyra.

Ndërsa në rastin e punonjësës ***** , konstatimi si më sipër, është vënë në dukje në pjesën e materialit ku flitet për situatën e administrimit të burimeve njerëzore në institucionin *Bashkia Vorë*, në paragrafin ”d” të raportit ”*Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuar nga nëpunës të transferuar për shkak ristrukturimi të institucionit*”, pika 4, ku bëhet fjalë për emërimin e ***** , në pozicionin *Specialiste në Sektorin e Financës* pranë Bashkisë Vorë dhe i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse rregullimi i situatës në këtë rast.

- në 5 raste, konstatohet se, punonjësit, të cilët në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar), kanë qenë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, më pas janë larguar (arsim i mesëm).
- 2 pozicione pune kanë qenë vende të lira.

Punonjës të emëruar me akte emërimi të përkohshëm pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), pranë komunës Prezë, aktualisht Njësia Administrative Prezë.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se, në tre raste, pas hyrjes në fuqi të ligjit, në këtë subjekt, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme.

Në rastin konkret bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

- ***** , emëruar në pozicionin “*Specialist në Zyrën e Informacionit*”, me aktin nr.55, datë 15.08.2014. Konstatohet se, njësia përgjegjëse e komunës, në këtë rast, ka nxjerrë aktin nr.230, datë 08.06.2015, duke e deklaruar *nëpunës civil në periudhë prove*. Pas ristrukturimit, njësia përgjegjëse, me aktin nr.13/44, datë 01.09.2015, e ka riemëruar “*Specialist shërbimesh*” pranë Njesisë Administrative Prezë.

- ***** , emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*”, me aktin e emërimit nr.25, datë 15.04.2014. Më pas, me aktin nr.224, datë 08.06.2015, është deklaruar *nëpunës civil në periudhë prove*. Pas ristrukturimit, njësia përgjegjëse, me aktin nr.13/43, datë 01.09.2015, e ka riemëruar “*Specialist finance*” pranë Njesisë Administrative Prezë.

- ***** , emëruar në pozicionin “*Specialist në Zyrën e Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës*”, me aktin nr.38, datë 15.05.2014 dhe deklaruar *nëpunës civil* me aktin nr.220, datë 08.06.2015. Pas ristrukturimit, njësia përgjegjëse, me aktin nr.22, datë 13.09.2015, e ka liruar nga detyra për shkak të shkurtimit të vendit të punës dhe, ky punonjës, ka shkëputur marrëdhëniet financiare në datën 01.10.2015.

Konkluzion: Në lidhje me këto raste, Komisioneri konkludon se, veprimi i njësive përgjegjëse të komunës për emërimin në pozicione pune pjesë e shërbimit civil me akte të përkohshme emërimi pas hyrjes në fuqi të ligjit, konsiderohet veprim në kundërshtim me ligjin.

Në rastin e punonjësve ***** dhe *****, ky veprim ka vijuar edhe nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Vorë, e cila, në përfundim të procesit të ristrukturimit, duke i konsideruar këta punonjës nëpunës civilë, i ka riemëruar përsëri në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Vërejmë se, ristrukturimit i institucionit, është një proces që kryhet nga njësia përgjegjëse nëpërmjet një mekanizmi të tillë siç është Komisioni i Ristrukturimit, ku shqyrtohen mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil. Mbi bazën e propozimeve të këtij komisioni, njësia përgjegjëse, nxjerr aktet e lirimit të nëpunësve civilë që u është deklaruar i tepërt pozicioni i punës apo aktet e riemërimit të nëpunësve civilë të mbetur pas ristrukturimit. Pra, ky proces, mundësohet dhe realizohet për çdo nëpunës civil të institucionit.

Nga sa më sipër, në rastin e dy punonjësve të cituar, nuk kemi të bëjmë me nëpunës civil, por me një veprim të gabuar të njësive përgjegjëse të komunës, e cila, jo vetëm i ka emëruar në kundërshtim me ligjin e ri, por edhe i ka konsideruar nëpunës civilë në periudhë prove. Ky veprim i gabuar, ka vijuar më tej edhe nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Vorë, e cila ka marrë të mirëqenë aktin e deklarimit të tyre nëpunës civilë në periudhë prove dhe, në përfundim të procesit të ristrukturimit, i ka riemëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Në këto rrethana, rekomandohet njësia përgjegjëse që për punonjësit ***** dhe ***** të revokojë aktet si më poshtë:

1. aktet fillestare të emërimit, respektivisht në pozicionet “*Specialist në Zyrën e Informacionit*” dhe “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*”, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune në pozicione që janë pjesë e shërbimit civil, e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar), sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës, nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë;
2. aktet e deklarimit të tyre si nëpunës civil në periudhë prove ;
3. aktet e riemërimit pas përfundimit të procesit të ristrukturimit, respektivisht në pozicionet “*Specialist shërbimesh*” dhe “*Specialist finance*”.

Të gjitha aktet që dokumentojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit në Njësinë Administrative Prezë, janë të evidentuara në tabelat:

Aneks 1 “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*”;

Aneks 2 “*Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë*

e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”.

IV. Situata aktuale në lidhje me administrimin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, në raport me situatën në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013 ”Për nëpunësin civil” (i ndryshuar).

Duke analizuar statistikat e prodhuara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, rezulton se, situata aktuale, e krijuar pas ndryshimeve të ndodhura për shkak të riorganizimit administrativo-territorial, mbështetur në ligjin nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar”, është e materializuar në strukturën e re të miratuar nga Këshilli Bashkiak Vorë me Vendimin nr. 7, datë 05.08.2015 “Mbi miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Vorë”, si dhe të strukturës të miratuar me Urdhrin nr.6, datë 20.08.2015 të Kryetarit të Bashkisë, materializohet në tabelën e paraqitur më poshtë:

Tabelë nr. 1: Situata në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil sipas strukturës aktuale.

Nr.	Institucioni	Punonjës gjithsej	Pozicione në shërbimin civil
1	Bashkia Vorë	85	57
2	Njësia Administrative Bërxull	26	7
3	Njësia Administrative Prezë	16	8
Totali		127	72

Ndërkohë, situata në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), që përkon me datën 26.02.2014, materializohet në tabelën më poshtë:

Tabelë nr. 2: Situata në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014.

Nr.	Institucioni	Punonjës gjithsej	Pozicione në shërbimin civil
1	Bashkia Vorë	65	42
2	Njësia Administrative Bërxull	57	16
3	Njësia Administrative Prezë	54	20
Totali		176	78

Nga analiza e të dhënave të paraqitura më sipër, rezulton se numri total i punonjësve të Bashkisë Vorë nga 176 punonjës tashmë është 127 punonjës, pra zvogëluar me rreth **28%**, ndërsa pozicionet e shërbimit civil nga 78 pozicione gjithsej, janë miratuar 72 pozicione pune në shërbimin civil, pra janë zvogëluar me rreth **8%**.

Kjo do të thotë se ky institucion është përfshirë në proces ristrukturimi, pasi ka shkurtime reale të pozicioneve të punës, si në numrin total të punonjësve, ashtu edhe në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil.

Siç e kemi thënë edhe më sipër në material, procesi i ristrukturimit të institucionit, është materializuar me miratimin e strukturës së re të institucionit dhe është shoqëruar me aktet e krijimit dhe të funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit; aktet e lirit të nëpunësve që u është deklaruar i tepërt pozicioni i punës; aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit.

Ky proces është realizuar nga njësi përgjegjëse, në përmbushje të kërkesave të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, (i ndryshuar), (në këtë rast pika 2, gërma “b”), Vendimit nr.142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*; Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, si dhe Udhëzimit nr.3, datë 14.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*, të cilat e kanë vendosur njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore, në krye të procesit të ristrukturimit, për tu kujdesur edhe në drejtim të anës procedurale ligjore.

Njësi përgjegjëse është struktura që krijon Komisionin e Ristrukturimit dhe pas propozimit të bërë prej këtij mekanizmi, ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirin nga shërbimi civil, të nëpunësve që i ka dalë i tepërt pozicioni i punës, ose i ka ndryshuar përshkrimi i punës.

Në rastin konkret, pas miratimit të numrit të përgjithshëm të personelit të Bashkisë nga Këshilli Bashkiak dhe pas miratimit të strukturës nga Kryetari i Bashkisë, njësi përgjegjëse ka udhëhequr procesin e ristrukturimit duke ndjekur këtë rend pune:

Me Urdhrin nr. 8, datë 20.08.2015 është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, i cili ka paraqitur propozimet për lirin nga shërbimi civil, të atyre nëpunësve, pozicioni i të cilëve nuk ekziston më, apo është riorganizuar, si dhe riemërimin në pozicione të të njëjtës kategori, kompetencë e tij që është e parashikuar në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, (i ndryshuar) dhe në Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*.

Përmbyllja e procesit është bërë nga njësi përgjegjëse, e cila, sipas dispozitave të mësipërme, pasi ka analizuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit, ka nxjerrë vendimin përfundimtar për lirin nga shërbimi civil, apo riemërimin në pozicione të të njëjtës kategori, duke nxjerrë akt individual për çdo nëpunës civil.

Konstatohet se, në rastet e lirit nga shërbimi civil, është respektuar procedura që parashikon pika 7 e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësit civil”*, (i ndryshuar). Në rastin konkret, punonjësit janë njoftuar paraprakisht mbi fillimin e procedurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit; mbajtja e një procesverballi, ku, nga njëra anë, njësi përgjegjëse ka parashtruar arsyet për marrjen e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe, nga ana tjetër, nëpunësi civil, është

shprehur në lidhje me këtë vendim; përmbylljen e këtij procesi me vendimin e lirimit nga detyra për shkak të ristrukturimit.

Ndërkohë, sjellim në vëmendje të institucionit se, duhet patur kujdes në lidhje me respektimin e të drejtës së dëmshpërblimit të këtyre nëpunësve në përputhje me vjetërsinë në punë, apo të drejtën për të konkurruar për një periudhë 2 vjeçare në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.



Këto ishin konstatimet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, gjatë mbikëqyrjes në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Vorë, në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore të statusit të punësimit, të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), si dhe në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (ndryshuar me Vendimin nr. 532, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave).

Të gjitha aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, njësitë që e përbëjnë aktualisht këtë subjekt të mbikëqyrjes, Bashkinë Vorë, Njësitë Administrative Bërçull dhe Prezë, janë materializuar në tabelat:

Aneksi nr. 1 “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar)”.

Aneksi nr.2 “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”.

K O M I S I O N E R I

Pranvera STRAKOSHA